

FJALA E DEPUTETIT EDUARD SHALSI

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Fort të nderuar kolegë deputetë, përfshirë ju të opozitës,

Do të doja ta shmangia që të flisja pas Sali Berishës, por është e pashmangshme. Të them të drejtën, nuk është thjesht i plakur, por, me sa duket, nuk është rritur dhe nuk është ngritur as në nivelin e një lideri mediokër. Në atë moshë, zakonisht, paqja, reflektimi dhe përgjegjshmëria ngrihen në një nivel tjetër, por, kur e kam parë si është sjellë me disa prej jush, nuk është më surprizë dhe, fatkeqësisht, sot flet edhe në emrin tuaj. Është dramatike dhe një leksion i madh për të gjithë ne se si nuk do të donim të plakeshim me një model që na turpëron të gjithëve, jo vetëm ju. E nisi si pishtar i demokracisë dhe përfundoi non-grata.

Nëse ka një gjë që ju takon juve ta zgjidhni, se nuk e zgjidhim ne, është modeli se si askush prej jush nuk duhet të jetë. Gjithsesi, ai i përket të kaluarës dhe ne e kemi thënë se nuk do të merremi me të, por i meritonte dy fjalë. Sot kemi debat për një institucion të rëndësishëm, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Ka ardhur koha që ne si deputetë, përveçse të konstatojmë çështjet, duhet të kuptojmë psenë. E mbani mend debatin e disa javëve më parë, kur hotelerive, për shkak të rritjes së çmimeve, iu turr një institucion? Pse ndodhi ajo? Në radhë të parë, ajo ndodhi se nuk u kuptua roli i Autoritetit të Konkurrencës dhe në radhë të dytë nuk u panë disa shembuj nga vende të tjera që organizonin evente dhe në pikën e eventeve rriteshin çmimet, siç ndodh me Bienalen e Venecias, siç ndodhte me Formula 1 në Barcelonë, siç ndodhte me panairët e Milanos.

Pra, na duhet të kuptojmë realisht rolin e këtyre institucioneve. Para disa kohësh ndodhi një ngjarje. Policia, me të drejtë, për shkak të vjedhjes së energjisë, bllokoi një biznes, por a kemi folur ne sa duhet mbi trendin e kriptomonedhave? Sa i kuptojmë ne ato? Çfarë presim? Është e lehtë t'i thuash një autoriteti “çfarë bëre ti për një aktivitet ilegal”, por ne jemi parlamentarë

dhe kemi përgjegjësinë të ulemi me drejtuesit dhe me punonjësit e këtyre autoriteteve. E kam thënë edhe më parë: nëse nuk i kuptojmë se në çfarë mjedisesh punojnë, nëse nuk kuptojmë se çfarë sistemesh informacioni përdorin, nëse do të fusim hundët, siç ka ndodhur rëndom, me emërime politike, nepotike, quajini si të doni, pastaj t'u kërkojmë llogari, nuk ka për të funksionuar.

Na takon neve që, nëse ndodh një ngjarje, të kuptojmë pse ndodhi kjo ngjarje. Pse kompanitë e sigurimit kanë një treg padrejtësisht të ndarë sipas disa përqindjeve? Pse është bërë e pamundur të disiplinohet kjo gjë? Fondi i kompensimit u përdor me shumë të drejtë. Si ka shkuar, ka shkuar duke u reduktuar apo ka shkuar duke mos u reduktuar? Autoriteti ka hapur disa pista interesante dhe të domosdoshme për zhvillimin e ekonomisë. Ne kemi miratuar disa ligje shumë të mira që mbeten për t'u aplikuar. Ne kemi përgatitur një rezolutë për autoritetin në fjalë, të cilën do ta ndjekim me shumë vëmendje me kolegët deputetë të maxhorancës dhe të opozitës në komision.

Gjithashtu, kemi rakorduar edhe se si të jemi më pranë këtyre institucioneve, jo një herë në vit, por mundësisht çdo muaj, për t'i pyetur, për të kërkuar prej tyre dhe për të kuptuar më mirë pshenë e shumë e shumë problemeve. Kemi shumë punë për të bërë në këtë kontekst. Larg politikës edhe ky është një autoritet shumë i rëndësishëm, politikat e të cilit kanë një impakt të drejtpërdrejt. Për më tepër, duhet të dini se janë miratuar disa ligje shumë të rëndësishme, të cilat, nëse nuk do të aplikohen siç duhet, pasojat do të jenë shumë të dëmshme për ekonominë. Unë për vete nuk kam qenë ndonjëherë aq i zoti, sa të kuptoj gjeopolitikën si disa nga kolegët e mi, por na takon të përqendrohemi realisht në disa çështje, që mund të stimulojnë ekonominë, mund të rrisin prodhimin, mund të rrisin punësimin, dhe, mbi të gjitha, duhet të vetëndërgjegjësohemi për rolin dhe çfarë mund të bëjmë ne.

E fundit, shpeshherë na takon neve të ulim bashkë disa institucione. Ne e dimë se komunikimi personal është problem i madh në vend, imagjinoni komunikimin institucional. Pra, nëse institucionet nuk komunikojmë siç duhet me njëra-tjetrën, atëherë problemi mbetet kopil, siç ndodhi me rastin e shqetësimit të drejtë për aktivitetin e paligjshëm të disa kompanive, që çoi në heqjen e gjashtë licencave, të cilat, në fakt, në dijeninë time, operonin konform ligjit.

Ndaj, këtu shtohet përgjegjësia dhe roli ynë që, kur 3-4 institucione nuk mund të komunikojnë siç duhet me njëra-tjetrën, ne duhet të ndërhyjmë. Ky është roli ynë, të ndërhyjmë. Nëse është e vështirë të komunikohet midis policisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes apo Autoritetit të Mbikëqyrjes dhe një autoriteti tjetër, jemi ne që mund të luajmë një rol. Le të përqendrohemi te çështjet që realisht kanë lidhje me zhvillimin e ekonomisë. Faleminderit!